



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.51/2016

Prishtinë, më 22.3.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, dhe Blerim Grainca, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj, Enver Hoti, dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Flutura Shala, Agim Kukaj dhe Alban Kaçiku –MZHE, Artan Venhari – ZAP, Fjolla Uka – KDI, Dardan Abazi – INDEP, Lekë Batalli – GLPS, Ismail Shabani-Kosova Press, Drilon Asllani- Radio Dukagjini dhe Evlina Kabashi, praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.3.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit të Performancës të Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendit i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.3.2016;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 15.3.2015, u miratua me plotësimin e dhënë nga deputeti Raif Qela, si vijon: “përgatitja e termave të referencës për “TREPÇËN” si dhe organizimi i takimit me palë të interesit, lidhur me këtë çështje”.

3. Shqyrtimi i Raportit të Performancës të Ndërmarrjeve Publike, për vitin 2014;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha që Komisioni e ka shqyrtuar njëherë Raportin e Performancës të Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014, por kemi kërkuar informata shtesë për shkak të mungesës së të dhënave për të kompletuar në detaje këtë raport. Ndërsa, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, që është në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, e ka sjellë një raport shtese më informata më të detajuara, por ajo që është kërkuar për pagat dhe bonuset e bordeve të ndërmarrjeve publike nuk është paraqitur në raportin shtesë.

Flutura Shala, u.d. e drejtorit e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, tha se arsyeja pse nuk e kemi paraqitur në raportin shtese, është sepse Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, nuk e posedon këtë informatë për vitin 2014.

Kryetari, tha që mesatarja e pagave, siç është rasti i PTK-së, kemi ndërmarrje publike që nuk ka treguar performancë të mirë dhe kanë pas rritje të pagave, këtu duhet ta shikojmë përgjegjësinë e bordeve dhe të menaxhmentit se sa janë duke u treguar të suksesshme ndërmarrjet publike, andaj, pagesat e bordeve duhet të trajtohen me prioritet, pasi që anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike kanë shumë benifite e shumë pak rezultate. Këto çështje i kemi rregulluar edhe kur është bërë plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Nëse ndërmarrja publike nuk ka rezultate pozitive, atëherë bordi i ndërmarrjes së caktuar duhet të thirret në përgjegjësi, pse nuk ka pas performancë të mirë dhe pozitive në ndërmarrjen të cilën e udhëheqin.

Raif Qela, tha se duke e shqyrtuar Raportin vjetor të ndërmarrjeve publike, lidhur me bordet, mendoj që jo vetëm që duhet të kërkojmë llogaridhënie në vazhdimësi prej tyre, por edhe aty ku shihet se ka pengesa, të bëjmë përpjekje që bordet të freskohen me njerëz të cilët janë me të përgatitur profesionalisht. Jo gjithmonë po veprohet kështu, dhe jo gjithmonë po zgjidhen bordet në përputhje me këtë kriter. Por, megjithatë kjo nuk është pjesë e këtij raporti. Plotësimin e raportit unë e shoh si diçka pozitive. Në përgjithësi ne duhet të jemi në një minimum të kënaqësisë me çka përfaqësuesit e MZHE-së kanë ofruar në këtë raport, dhe pyetjet të cilat ne i kemi shtruar për MZHE-në nuk janë dhënë akoma e në veçanti nuk janë dhënë sqarime se pse ka rënie të të hyrave në një pjesë të konsiderueshme të ndërmarrjeve publike.

Unë do ta kisha theksuar në veçanti gjendjen në Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës, nuk mendoj se rënia është vetëm si rezultat i ofrimit të aplikacioneve pa pagesë përmes internetit, por janë edhe një sërë faktorësh që ndër të tjera duhet të shqyrtohet edhe raporti i kompanive publike me agjencitë e pavarura, sa janë korrekte agjencitë e pavarura në raport me

këto kompani publike, sa është duke u zbatuar Ligji i Konkurrencës, sa i ka penguar monopoli disa prej kompanive publike, sepse edhe problemi i monopolit është njëri prej atyre faktorëve që kanë ndikuar në disa prej ndërmarrjeve publike që të kenë performancë të dobët.

Besim Beqaj, tha se ne raportin shtesë kemi disa informata me të dhëna më të detajuara. Lidhur me performancën e bordeve të ndërmarrjeve publike, nuk është çështje vetëm e MZHE-së, pasi që në borde përfaqësojnë aksionarin në ndërmarrjet publike. Performanca e bordeve është çështje e Komitetit Ndërministror për bordet e ndërmarrjeve publike.

Z. Beqaj theksoi se në kuptimin e performancës së ndërmarrjeve kemi dilema, sepse kemi rritje të pagave edhe bonuseve që merren, pa treguar ndonjë rezultat në punën e ndërmarrjes, dhe nuk merren me rritjen e performancës së ndërmarrjes, por Njësia për Monitorim këtu nuk mund të përfshihet, pasi që emërimet e bordeve i bënë drejtpërdrejt Qeveria dhe kemi vendime të marra nga bordet që do ta përkeqësojnë gjendjen e performancës së ndërmarrjeve publike. Andaj, lidhur me vendimet bordeve të ndërmarrjeve publike, përgjegjës është Komiteti Ndërministror, tha Beqaj.

Fatmir Rexhepi, tha që është në interes nxjerrja e një vlerësimi të drejt, në atë që e ka ngritur Komisioni. Pasqyra e ndërmarrjeve publike paraqet një performancë që është duke shkuar ka përkeqësimi i performancës në rezultate negative. Sa i përket bordeve, Rexhepi theksoi, që e kanë pasur një rol që nuk e kanë përfaqësuar mirë deri tani në ndërmarrjet publike, prandaj i mbetet Qeverisë që më shumë t'i kushtojë kohë, duke u marrë me aktivitetin e mbikëqyrjes se punës të bordeve të ndërmarrjeve publike, sidomos me atë çka ka të bëjë më asetet edhe me mënyrën e menaxhimit të mjeteve financiare.

Blerim Grainca, tha sa ajo çka është në vazhdimësi negative për ndërmarrjet publike, është inkasimi i vogël i të hyrave për shërbimet që i ofrojnë për konsumatorët dhe burimi i të hyrave është mjaftë më rendësi për afarizmin e një ndërmarrje, për të pasur një performancë të suksesshme. Po ashtu, në disa ndërmarrje publike shfaqet problemi i politikave të punësimit, punësimi i një numri të madh, që paraqet problem për një afarizëm pozitiv. Po ta vlerësojmë performancën e bordeve që kanë qenë në atë kohë, atëherë këtë raport në parim nuk duhet ta votojmë.

Besim Beqaj, potencoi se informata shtesë e raportit paraqet gjendjen reale dhe faktike që ekziston në këto ndërmarrje publike, ndërsa, kur ta shqyrtojmë në seancë plenare raportin e performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014, aty duhet të jetë edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, për të dhënë përgjigje dhe arsyetuar përfaqësimin e bordeve të ndërmarrjeve publike.

Artan Venhari, Zyra Auditorit të Përgjithshëm, tha se kemi shikuar performancën e bordeve vetëm për një periudhë të kufizuar, e cila ka qenë gjatë vitit 2013 dh ka dalë në publikimin në vitin 2014. Synimi ynë kryesor ka qenë që ta shohim mungesën sistematike në sistem, sa i përket mbikëqyrjes dhe dobësive të cilat po shfaqen edhe me performancën e bordeve, mirëpo, çka ka qenë me rendësi për ne si zyrtarë të Zyrës së Auditorit, të shohim sistemin e mbikëqyrjes se ndërmarrjeve publike lidhur me performancën e tyre. Mirëpo, edhe hapjen, transparencën e atyre që të këtë më shume informata.

Ai theksoi, se nëse mund të japë një konkluzion, ajo që shpresova të dëgjojë është lidhur me rekomandimet që ka dhënë Zyra e Auditorit në raport, i cili është publikuar në vitin 2014, sesi të gjeturat e atij raporti dhe rekomandimet janë marr dhe si janë zhvilluar në raportin që e ka prodhuar, Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Do të thotë, Njësia për Monitorim lidhur me bordet. Jemi të interesuar, edhe ne si Zyrë e Auditorit, së shpejti në periudhën tjetër të hyjmë dhe të bëjmë rishikimin e këtij raporti, që të marrim informatat lidhur me veprimin e bordeve në këto vitet pasuese, do të thotë pas daljes së raportit, sesi bordet sa i përket zhvillimit të tyre kane reaguar dhe si ka shkuar në vitet për të cilat po diskutohet.

Kryetari, tha se në bazë të diskutimeve, mund të nxjerrim këto konkluzione me këto rekomandime : Komisioni konstaton se Raporti i Performancës së Ndërmarrjeve Publike, jep disa të dhëna të cilat tregojnë lëvizjen e shitjeve dhe treguesve të tjerë të afarizmit, por nuk jep në mënyrë të plotë pasqyrën dhe performancën e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike; Komisioni rekomandon që Qeveria dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, të ndërmarrin masa për aftësimin e Njesisë Monitoruese për Ndërmarrjet Publike, që ajo të jetë në gjendje që të mbikëqyrë në mënyrë sistematike dhe të plotë performancën e këtyre Ndërmarrjeve, përgjegjësinë e bordeve dhe trendët e zhvillimit të këtyre ndërmarrjeve; Qeveria duhet të ndërmarrë masa për të kërkuar transparencën dhe llogaridhënien e Bordeve, lidhur me zhvillimet, suksesin financiar dhe ruajtjen e vlerës së aseteve të Ndërmarrjeve Publike; Rekomandohet që Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Auditori Gjeneral, të përcaktojnë procedurat për auditimin e ndërmarrjeve publike dhe që Auditori Gjeneral të merr përgjegjësinë e auditimit të këtyre ndërmarrjeve publike; Po ashtu, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Qeveria, ta ashpërsojnë përgjegjësinë për zbatimin e rekomandimeve të auditorit në ndërmarrje publike.

Blerim Grainca, kërkoi sqarime a po votohet Raporti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik si raport apo edhe performanca e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014.

Sala Berisha- Shala, kërkoi që të votohet Raporti i Performancës për ndërmarrjet publike për vitin 2014, me rekomandime të cilat i propozoi kryetari i Komisionit z. Muhamet Mustafa, sepse nuk përmirësohet raporti më mosvotim. Ajo propozoi që në të ardhmen Komisioni në terren t'i shohë për së afërmi problemet më të cilat po ballafaqohen këto ndërmarrje publike.

Fatmir Rexhepi, potencoi se Qeveria e ka aprovuar si të tillë dhe Komisioni ka kërkuar raport shtesë, duke i marrë këto informata të vlerësimit dhe konstatime të gjendjes reale të ndërmarrjeve publike. Ai tha, që disa prej ndërmarrjeve publike, nuk kanë pasur plan të biznesit dhe rezultati ka munguar. Andaj, ndërmarrjet publike për të ardhmen, duhet të kenë një plan strategjik se ku duhet të arrijnë dhe si do t'i realizojnë detyrat dhe përgjegjësit që i kanë për të pasur rezultate pozitive.

Raif Qela, propozoi që një prej rekomandimeve duhet të jetë : të sqarohen në hollësi shkaqet e rënies së performancës së Ndërmarrjeve publike (aty ku ka rënie), duke i trajtuar të gjithë parametrat pengues dhe duke përcaktuar përgjegjësinë e bordeve.

Pas debatit Komisioni, me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I. Kuvendi i Republikës së Kosovës të shqyrtojë Raportin e Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014, dhe ta miratojë atë me rekomandimet në vijim:

- 1. Njësia përkatëse në MZHE, duhet të avancojë mënyrën e raportimit – strukturën dhe përmbajtjen e Raportit vjetor të performancës së Ndërmarrjeve Publike , ipas Ligjit përkatës për Ndërmarrjet Publike.*
- 2. Qeveria, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik, të ndërmarrin masa për ngritjen e kapaciteteve dhe aftësisë së Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, që ajo të jetë në gjendje që të mbikëqyrë në mënyrë sistematike dhe të plotë performancën e këtyre Ndërmarrjeve, përgjegjësinë e Bordeve dhe trendët e zhvillimit të këtyre ndërmarrjeve;*
- 3. Qeveria të ndërmarrë masa për të kërkuar transparencën dhe llogaridhënien, përkatësisht përgjegjësinë e bordeve, lidhur me zhvillimet, suksesin financiar dhe ruajtjen, përkatësisht rritjen e vlerës së aseteve të Ndërmarrjeve Publike sipas Ligjit mbi NP-të;*
- 4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Auditori Gjeneral, të përcaktojnë procedurat për auditimin e Ndërmarrjeve Publike. Komisioni propozon që Auditori Gjeneral të marrë përgjegjësinë e auditimit të këtyre Ndërmarrjeve Publike dhe vlerësimit të performancës së bordeve dhe menaxhmentit të tyre. Gjithashtu, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Qeveria, ta ashpërsojnë përgjegjësinë për zbatimin e rekomandimeve të auditorit në ndërmarrje publike;*
- 5. Raporti vijues të sqarojë në hollësi shkaqet e rënies së performancës së ndërmarrjeve publike (aty ku ka rënie), duke i trajtuar të gjithë parametrat pengues dhe përcaktuar përgjegjësinë e bordeve.*

4. Të ndryshme.

Çështje vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa